

2015

**[RAPORTI VJETOR I PUNËS SË
NISMËS SË TË RINJVE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË
PËR VITIN 2015]**

Raporti vjetor i punës së Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2015

I. Program i të drejtave të njeriut

1. Projekti “Udhëtim në Evropë”: promovimi i lirisë së lëvizjes në Evropë.
2. Procesi i ndryshimit të Ligjit për mbrojtje nga Diskriminimi (Avokatit të Popullit dhe Barazi Gjinore).
3. Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes.
4. Ligjeratë: Standardet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e shpifjes.
5. Monitorimi i zgjedhjes së Avokatit të Popullit.
6. Puna praktike për të rinjtë.
7. Trajnim mbi të drejtat e njeriut.
8. Forumi i aktivistëve kundër gjuhës së urrejtjes.
9. Java e të Drejtave të Njeriut.

II. Programi i bashkëpunimit rajonal dhe ballafaqimit me të kaluarën

1. Programi rajonal i shkëmbimit;
2. Sarajevo Youth Summit

III. Programi për të rinj: Edukimi dhe aktivizmi

1. Aksion rrugor për personat e pagjetur
2. Kampanja “I was a refugee”
3. Youth Linc
5. Aktivizmi – Nisma ime.

IV. Avokim

1. Grupi ndërministror për ballafaqim me të kaluarën dhe pajtim
2. Grupi këshilldhënës dhe konsultativ për të Drejtat e Komunitetit LGBT
3. Gjenocidi Armen
4. Gjykata Speciale

Përmbledhje

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kosovë (YIHR KS) në vitin 2015 ka vazhduar implementimin e projekteve të cilat janë zhvilluar në kuadër të programeve ekzistuese. Edhe në këtë vit, Nisma ka bërë monitorimin e legjislacionit dhe institucioneve relevante për të drejtat e njeriut, ka raportuar lidhur me punës së këtyre institucioneve dhe njëkohësisht ka promovuar liritë dhe të drejtat e njeriut në Kosovë. Përveç kësaj, gjatë vitit YIHR KS-në e kanë shoqëruar ndryshime të konsiderueshme në staf, duke hapur kështu rrugën për përgatitjen e gjeneratës së ardhshme të liderëve të organizatës. Njëkohësisht, YIHR KS iu dha mundësinë 5 praktikantëve që të jenë pjesë e stafit dhe të përfitojnë përvojë nga puna e organizatës.

Në këtë raport janë përmbledhur aktivitetet kryesore të organizatës në vitin 2015. Struktura e Programeve mbetet e njëjtë me atë të viteve të kaluara:

- Programi i të drejtave të njeriut
- Programi i bashkëpunimit rajonal dhe ballafaqimit me të kaluarën
- Programi për të rinj: edukimi dhe aktivizmi si dhe
- Programi i granteve të vogla

Një ndër të arriturat më të mëdha të këtij viti ishte kthimi i vizibilitetit të prganizatës në opinion dhe shtimi i të rinjve të angazhuar në aktivitetet e organizatës.

Edhe gjatë vitit 2015, një numër i pjesëmarrëseve të profileve të ndryshme kanë kaluar nëpër projektet e realizuara nga muaji janar deri në fund të muajit dhjetor. Më tepër se 300 aktivistë u angazhuan në fushata dhe aksione të ndryshme të rrjetit të aktivistëve, Nisma Ime; rreth 40 të rinj nga rajoni patën mundësinë të vizitonin Kosovën dhe 23 të rinjë nga Kosova patën mundësi të jenë pjesë e Sarajevo Youth Summit; 15 të rinj udhëtuan për herë të parë në shtetet e Bashkimit Evropian; rreth 30 aktiviste të rinj ndihmuan YIHR KS-së në luftën kundër gjuhës së urrejtjes ; si dhe dhjetëra jurist të rinj morën njohuri bazike mbi mekanizmat shtetërorë dhe ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, kundër-diskriminimit dhe gjuhën e urrejtjes.

I. Program i të drejtave të njeriut

YIHR KS ka vazhduar edhe më tej zhvillimin e programit për të drejtat e njeriut. Edhe këtë vit, YIHR KS ka raportuar mbi respektimin e të drejtave të njeriut, ka avokuar për ndryshimin e Ligjit Kundër Diskriminimit, Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Ligjit për Barazinë Gjinore; ka hulumtuar dhe raportuar mbi praninë e gjuhës së urrejtjes në portalet online, ka monitoruar e procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, ka kontribuar në edukimin e juristëve të rinj si dhe ka promovuar lirinë e lëvizjes dhe të drejtave të minoriteteve.

1. Programi Udhëtim në Evropë: promovimi i lirisë së lëvizjes në Evropë – Në vitin 2015, Nisma organizoi përsëri Programin “Udhëtim në Evropë”. Ky ishte viti i dhjetë, ku 15 studentë nga qytete dhe Universitete të ndryshme të Kosovës kanë udhëtuar për një muaj në shumë shtete Evropiane. Destinacioni i parë si zakonisht ishte qyteti i Berlinit, prej nga studentët kanë vazhduar udhëtimin në shtetet tjera Evropiane sipas preferencave të tyre. Në kuadër të këtij projekti, studentëve u sigurohen viza Shengen, sigurime shëndetësore, bileta të trenit Inter-rail të vlefshme për një muaj, kartela studentore si dhe u mbulohen shpenzimet e tjera për dy ditët e para të qëndrimit në Berlin. Projekti kishte vizibilitet të madh dhe si rezultat, shume të rinjë u interesuan për projektin dhe punën tonë në përgjithësi.

Projekti është mbështetur nga Fondacioni Robert Bosch, Balkan Trust for Democracy dhe Ambasada Gjermane në Prishtinë.

2. Procesi i ndryshimit të Ligjit Kundër Diskriminimit (Ligjit të Avokatit të Popullit dhe Ligjit për Barazi Gjinore) – YIHR KS e përkrahur nga CRD, vazhdoi avokimin gjatë procesit të ndryshimit të Ligjit Kundër Diskriminimit, Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Ligjin për Barazi Gjinore. YIHR KS mori pjesë në grupet punuese dhe seancat dëgjimore të organizuara nga Zyra e Kryeministrit, në takimet e konsultimet e organizuara nga institucionet ndërkombëtare si dhe në takimet e Komisionit parlamentarë për të drejtat e njeriut, personat e pagjetur dhe peticione. Ligjet përfundimisht janë aprovuar në qershor të vitit 2015 dhe kanë hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015.

- 3. Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes** – Gjatë vitit 2015, YIHR KS vazhdoi me monitorimin e gjuhës së urrejtjes dhe lirisë së shprehjes. Si rezultat, YIHR KS bëri deklarata publike duke i dënuar aktet që transmetuan gjuhë të urrejtjes si dhe bëri ankesa kundër portaleve dhe medieve të shkruara në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës. Si rrjedhojë e angazhimit të stafit, praktikantëve dhe aktivistëve të rinjë, YIHR KS ka paraqitur 201 ankesa në KMSHK me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes, ku prej tyre 186 janë aprovuar. Monitorimi u zhvillua në kuadër të projektit të përkrahur nga Civil Rights Defenders.
- 4. Takimi nacional “Të drejtat e komunitetit LGBT në rajon”**- YIHR KS dhe partnerët e rrjetit rajonal HAPI organizuan takimin e parë rajonal në Kosovë. Qëllimi i këtij takimi ishte krijimi i një rrjeti të organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe individëve të interesuar nga Serbia, Kosova dhe Mali i Zi, me qëllim të diskutimit dhe dhënies së kontributit në përmirësimin e respektimit të të drejtave të komunitetit LGBT në rajon.

HAPI është një koalicion i organizatave joqeveritare nga Serbia, Kosova dhe Mali i Zi, të cilat janë organizuar me qëllim të luftimit të diskriminimit në nivel rajonal. Anëtarët e HAPIT janë: Komiteti i Juristëve për të Drejtat e Njeriut - YUCOM, Qendra Beogradase për të Drejtat e Njeriut, Rrjeti CHRIS, Qendra për Edukim Qytetar - Mali i Zi, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë), Gay Straight Aleanca, Forumi LGBT Progress Mali i Zi dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut-Kosovë (YIHR KS).
- 5. Monitorimi i zgjedhjes së Avokatit të Popullit** – Kuvendi i Kosovës në fillim të vitit 2015 filloi procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit me ç’rast YIHR KS si vazhdimësi e punës së mëhershme u angazhua në monitorimin e këtij procesi. Si rezultat, YIHR KS u përkushtua që procesi i zgjedhjes së Avokatit të Popullit të jetë i rregullt dhe transparent. Megjithatë, në fazën përfundimtare Kuvendi dështoi që të zgjedh Avokatin e Popullit prandaj u morr vendimi për rishpalljen e konkursit. Raundi i tretë i zgjedhjes së Avokatit të Popullit solli si Avokat z. Hilmi Jashari me të cilin kemi krijuar bashkëpunim të mirë.
- 6. Mundësi për punë praktike për të rinjtë** - Gjatë vitit 2014, YIHR KS iu ka ofruar mundësinë për punë praktike gjashtë studentëve të Fakultetit Juridik , të cilët u angazhuan kryesisht në implementimin e aktiviteteve të programit për të drejtat e njeriut dhe atë të edukimit dhe aktivizmit.

7. **Trajnim mbi të drejtat e njeriut** – YIHR KS, me përkrahjen e Civil Rights Defenders, organizoi trajnimin mbi të drejtat e njeriut e cila kishte për fokus ligjin për mbrojtje nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes. Ligjerues gjatë trajnimit ishin: Iliriana Islami, prodekane dhe ligjeruese e të drejtës publike në universitetin e Prishtinës, njëherit ish-gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese; sociologu Erëblir Kadriu, ligjeri për stereotipet dhe paragjykimet, përfshirë rolin e medieve; Rrahmon Salihu ligjeri konceptet kyçe dhe infrastrukturen ligjore në Kosovë, standardet ndërkombëtare dhe mekanizmat vëtrregullues; Edona Tolaj, ka udhëhequr ushtrimet rreth këshillimeve në rast ankese dhe vlerësimit të rasteve. Trajnimi ishte një mundësi e shkëlqyer që pjesëmarrësit të angazhohen dhe të praktikojnë atë që kishin mësuar gjatë ditëve të mëparshme të trajnimit. Në përgjithësi trajnimi u ka ofruar qasje praktike për të drejtat e njeriut duke i njoftuar studentët në mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë për drejtave të njeriut.

8. **Forumi i aktivistëve kundër gjuhës së urrejtjes** - YIHR KS lansoi forumin e aktivistëve kundër gjuhës së urrejtjes në një koktej rasti. Pjesëmarrësit e forumit janë pjesëmarrës në punëtoritë mbi lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes. Ky forum do të shërbejë si platformë përmes së cilës anëtarët do të kenë mundësi që të diskutojnë, raportojnë dhe reagojnë në rastet e shkeljeve të lirisë shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes.

9. **Java e të Drejtave të Njeriut** –YIHR KS gjatë vitit 2015 organizoi edicionin e dytë të javës së të drejtave të njeriut. Gjatë kësaj jave u shënuan këto aktivitete:

○ **Tryezë e rrumbullakët "Të drejtat e njeriut mundësitë e humbura dhe të fituara në vitin 2015"** Gjatë kësaj tryeze të rrumbullakët u prezantuar raporti në lidhje me ngjarjet kryesore që shënuan vitin 2015. Panelitë në këtë tryezë ishin: KujtimPaçaku - Anëtar i Komisionit të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësues i komunitetit rom në Kuvendin e Kosovës, Z. Habit Hajredini - Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, z. AndreyEsin - Këshilli i Evropës, Misioni në Kosovë , Znj GjylietaMushkolaj - Profesoreshë në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe ish-gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Sesioni i dytë i tryezës iu dedikuar publikimit të raportit "**Sa e njohin të rinjtë shqiptarë dhe serbë njëri-tjetrin?**". Raporti është rezultat i punës së aktivistëve në baza vullnetare dhe paraqet gjetjet e kryera nga anketat e drejtpërdrejta me të rinjtë nga i tërë territori i Kosovës.

○ **Screening of the Documentary movie "Sepideh - Reaching for the Stars"**. YIHR KS në vitin 2015 ka filluar me aktivitetin e shfaqjes së filma që trajtojnë çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut. Duke vërejtur se aktivitetet e tilla kanë hasur në interesimin e të rinjve, ditën e dytë të Javës së të Drejtave të Njeriut i është dedikuar shfaqjes së filmit dokumentar dhe diskutimit me pjesëmarrësit. Gjatë gjithë vitit YIHR KS organizoi 7 netë filmi që trajjnë çështje të ndryshme për të drejtat e njeriut, siç janë: "Missed and still missing" (për të shënuar ditën kombëtare për personat e zhdukur), "1915 AGHET" (një dokumentar për gjenocidin armen, si pjesë e EGAM), "Concerning Violence" - ngjarja fitoi edhe vëmendjen e gazetës "Zëri", "Prayers for Bobby", "Selma" dhe "The boy in the striped pajamas". Aktivistëve u është ofruar munësia e sugjerimit të filmave, prezantimit të tyre dhe udhëheqjes së debatit më pas. Si

rezultat, YIHR KS është bërë vend ku të rinjtë diskutojnë për të drejtat e njeriut duke kontribuar kështu në edukimin joformal dhe ngritjen e vetëdijes për shkeljet e të drejtave të njeriut.

○ ***Diskutim: Të drejtat e njeriut nga perspektiva e të rinjve***

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe fuqizimit të aktivistëve të rinj për të drejtat e njeriut, YIHR KS organizoi diskutimin për të drejtave të njeriut me aktivistë të rinjë të cilët prezantuan përpjekjet e tyre drejt një shoqërie më gjithpërfshirëse.

Si panelist ishin të ftuar: Rron Gjinovci, aktivist i të drejtave të njeriut i cili është i përfshirë në mënyrë aktive në edukimin komunitetit rom, Rajmonda Sylbije, Drejtoreshë Ekzekutive e CEL dhe e vetmi pjesëmarrëse e "projektit Natalia" nga Kosova, Elonë Kastrati, feministe që u bë e njohur ndërkombëtarisht për aktivizmin e saj në Gjermani dhe tani në Kosovë dhe Gresa Musliu nga BIRN e cile diskutoi për rëndësinë e qasjes në dokumente zyrtare.

○ ***Aksioni rrugor***

Duke pasur parasysh se 2015 u shënuar me rritjen e numrit të rasteve të dhunës në familje dhe dështimit të institucioneve për të trajtuar ato raste, si dhe domenin publik që ende trajtohen si çështje private. YIHR KS ka vendosur katër parulla (3mx2m) përgjat Sheshit Nëna Terezë. Parulla e pari përmbante emrin "Diana" viktimë e dhunës në familje, e ndjekur nga emri "Zejnepe" një tjetër viktimë e kohëve të fundit e dhunës në familje. Duke qenë të vetëdijshëm se ka shumë raste të tjera që ndodhin, parulla e tretë kishte vetëm tri pika "... " që simbolizonin rastet e panjohur dhe viktimat e mundshme .. Në parullën e katërt YIHR KS ka shprehur kërkesën drejtuar institucioneve të Kosovës për të krijuar një shoqëri ku dhuna nuk tolerohet dhe drejtësia nuk vonohet. Një aktivitet tjetër rrugor ishte rrethimi i ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke mbajtur në duar pankarta me kërkesa si: e drejta për qasje në dokumente publike, e drejta për arsim cilësor, të drejtën për të ditur të vërtetën për të kaluarën etj. Mesazhet dhe rrethimi kërkonin ndërhyrje urgjente nga institucionet në krijimin e kushteve për mbrojtjen dhe realizimin e këtyre të drejtave, si çështja e personave të zhdukur, sistem më të mirë arsimimi, martesat e homoseksualëve, mesazhet që luftojnë paragjykimet dhe stereotipet, themelimin e KOMRA-s, mesazhe kundër segregacionit. Mesazhet ishin: "Dua të udhëtoj nëpër Europë pa viza", "Martesa është e drejta e të gjithëve", "Po du KOMRA", "Ku janë 1655 persona ende të pagjetur?", "Vota jote jo e babës", "Respekto votën time" "Shamia dhe mjekrra nuk më bëjnë terrorist", "Çfarë bëj nën jorgan tim është puna ime" etj. Poashtu, janë shënuar mesazhe në gjuhën serbe dhe rome, si "Kosovo za sve" dhe "Kosova Sarvorenge", të cilat janë pritur shumë mirë nga këto komunitete.

○ ***Certifikimi i pjesëmarrësve të trajnimit për të drejtat e njeriut***

Gjatë kësaj dite pjesëmarrësit kanë zhvilluar finalen e garës në mbrojtjen e rasteve duke u bazuar në ligjin për mbrojtje nga diskriminimi. Si rezultat Ardit Ahmetaj dhe Gjylmser Nallbani janë shpallur si fitues të garës dhe do të mbajnë punë praktike në YIHR KS gjatë vitit 2016. Për të siguruar transparencën e procesit të përzgjedhjes të gjithë pjesëmarrësit morën pjesë në këtë ngjarje, dhe u emëruan në rolin e jurisë.

II. Programi i bashkëpunimit rajonal dhe ballafaqimit me të kaluarën

Në kuadër të programit të bashkëpunimit rajonal dhe ballafaqimit me të kaluarën përveç aktiviteteve të zakonshme të këmbimit, në fokus ka qenë krijimi i bashkëpunimit në mes të Fakulteteve të Shkencave

Politike në Prishtinë dhe Beograd. Përveç kësaj, YIHR KS ka zhvilluar aktivitete të shumta avokuese me qëllim të themelimit të Fondit Rajonal të Shkëmbimit.

- 1. Programi rajonal i shkëmbimit** – ka vazhduar duke angazhuar grupe të ndryshme profesionistësh në kuadër të këmbimit ndërmjet dy vendeve dhe këtë vit është punuar në krijimin e bashkëpunimit në mes të Fakulteteve të Shkencave Politike në Beograd dhe Prishtinë. Pavarësisht që projekti nuk u përkrah përfundimisht nga fakultetet, falë vullnetit të profesorëve në maj të 2015 u bë publikimi i librit në prani të profesorëve tjerë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare.
- 2.** YIHR KS së bashku me zyret tjera të YIHR-së në rajon është angazhuar në aktivizimin e ***Rrjetit Rajonal të Rinjve të Partive Politike***. Për dallim prej herave tjera, këtë vit kemi arritur të anëtarësojmë të rinjtë e dy prej partive në Kosovë PDK dhe AAK.
- 3.** Poashtu, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut organizoi një debat publik si pjesë e vizitës së njëzet aktivistëve të rinj nga Beogradi në kryeqytetin e Kosovës. Të rinjtë, shumica studentë të juridikut dhe shkencave politike në mes të moshave 23 dhe 25, kaluan tre ditë në Prishtinë duke u takuar me liderë politik dhe duke vizituar komuna të ndryshme, por edhe duke takuar të rinj e duke u kënaqur.

3. Avokimi për Krijimin e Zyres rinore të ballkanit përendimor

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë dhe zyret e YIHR-së në rajon, gjatë vitit 2014 kanë avokuar në instanca të dryshme shtetërore në shtetet respektive për formimin e Zyres rinore të ballkanit përendimor, projekt ky të cilin YIHR e ka realizuar me vitet të tëra. Avokimi është bërë për qëllim që të arrihet përkrahja nga ana e qeverive për themelimin e kësaj zyreje; të mundësohet pjesëmarrja e YIHR-së dhe të mirret parasysh përvoja e saj disa vjeçare në këtë drejtim. Kështu, për këtë qëllim janë realizuar takime me përfaqësues të partive politike në Kosovë për të siguruar përkrahje për themelimin e programit rajonal të këmbimit, program ky i cili do të themelohet nga shtet e Kosovës, Serbisë, Malit të Zi, Serbisë, Kroacisë, Bosnës dhe Hercegovinës, Maqedonisë dhe Shqipërisë. Në maj të vitit 2015, YIHR KS ka organizuar një konferencë nacionale për të diskutuar me

akterë relevantë në lidhje me rëndësinë e formimit të kësaj zyreje. Të ftuar si panelistë ishin anëtare të shoqërisë civile, përfaqësues të organizatave të të rinjve dhe përfaqësues të institucioneve.

Poashtu, në kuadër të avokimit për themelimin e zyes janë zhvilluar dhe takime të tjëera në Gjermani, për të patë nga afër funksionimin e zyreve të ngajshme dhe për të këmbyer përvojat. Ky projekt është rajonal dhe përkrahet nga Komisioni Evropian.

III. Programi për të rinj: Edukimi dhe aktivizmi

Në kuadër të këtij programi YIHR KS ka realizuar një varg aktivitete të cilat kanë pasur qëllim fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të të rinjve. Poashtu aksionet rrugore dhe kampanjat kanë vazhduar të jenë pjesë e aktiviteteve të YIHR KS.

1. **Aktivitete për personat e pagjetur**- Qysh nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, 16 vite më parë, nuk është arritur të ndriçohet fati i 1655 personave të cilët konsiderohen si të pagjetur. Kësisoj, familjarët e viktimave dhe shoqëria kosovare vazhdon të përballet me mohimin e së drejtës për të ditur të vërtetën dhe të drejtës për drejtësi. Andaj YIHR KS organizoi një eksion simbolik me rastin e ditë kombëtare të personave të pagjetur te memoriali që i dedikohet personave të pagjetur me vendosjen e orëve.

Aktivistët e Nisma Ime organizuan aksion simbolik edhe në prag të Ditës Ndërkombëtare për Personat e Pagjetur duke tërhequr vëmendjen drejt iniciativave të fundit të kujtesës kolektive nga lufta e fundit në Kosovë, të ndërmarra nga institucionet e vendit. Përmes këtij aksioni, aktevistët potencuan se memoriali elektronik pranë Kuvendit të Kosovës i cili vazhdon të mbetet i pakompletuar që nga perurimi, sikurse dhe memoriali tjetër i ngritur pranë tij i cili nuk mbanë asnjë mbishkrim, janë treguesit më të mirë që Kososva vuan nga një "kulturë e heshtjes" në lidhje me të kaluarën e saj të fundit, e bazuar kryesisht në mohimin e viktimave, posaçërisht atyre që i përkasin grupeve të tjera etnike. Poashtu, aktivistët realizuan një video me intervista të qytetarëve rreth memorialit ku vërtetohet fakti që memoriali nuk ka arritur qëllimin e tij. Aktivistët përmes këtyre aksioneve shprehën këmbëngulësinë e tyre që secila nismë e ndërmarrë nga institucionet tona lidhur me përkujtimin dhe nderimin, jo vetëm të personave të pagjetur por e të gjithë viktimave nga lufta e fundit në Kosovë, të mos jetë diskriminuese në asnjë formë. Poashtu, në shenjë përkujtimi të viktimave, aktivistët organizuan dhe një

instalacion në sheshin Zahir Pajaziti me karrike dhe ku u thirrën emrat e të gjithë personave të pagjetur pa dallim etnie.

2. **Kampanja “I was a refugee”** me rastin e fluksit të madhë të refugjatëve sirianë në Evropë, aktivistët e Nisma Ime organizuan një kampanjë vetëdijësuese për solidarizim dhe thirrje në ndihmë të refugjatëve. Përmes kampanjës qytetarët kishin mundësi që të dërgonin mesazhe te përfaqësues të shteteve Evropiane në mënyrë që t’u dilet në ndihmë refugjatëve duke i’u përkujtuar solidaritetin që Evropa tregoi me refugjatët nga Kosova gjatë luftës së fundit në Kosovë.
3. **Youth Linc** - Në bashkëpunim me YIHR në BiH, Mal të Zi dhe Kroaci, Qendrën për Hulumtimin e Politikave Rajonale dhe Bashkëpunim Studiorum në Maqedoni dhe Interneës BeH, YIHR KS ka vazhduar me implementimin e projektit Youth LINC i cili synon ngritjen e kapacitete të të rinjve për t’u ballafaquar me problemet e të drejtave të njeriut, krijimit të bashkëpunimit ndërmjet të rinjve të shteteve të rajonit, duke ju dhënë mundësi të krijojnë platforma inovative online.